

VENDIM
Nr. 64, datë 11.5.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË MARRËVESHJEN E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA DHE FURNIZUESIT MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 23, DATË 15.2.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 germa “h” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pika 4 e VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s mbi propozimin e OST sh.a., depozituar në ERE me shkresën nr. 2933 Prot datë 7.4.2017 për disa ndryshime në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti